

NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHITETET KU ATA BANOJNË

#93

TEKSTET/ Miratohet paketa e dokumenteve për konkurrimin për tekstet mësimore të përbashkëta Shqipëri-Kosovë



Për tri ditë me radhë Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e Teksteve të përbashkëta ka diskutuar dhe ka dhënë vendime, për një politikë të përbashkët për mësimdhënien në diasporë.

Komisioni miratoi paketën e plotë e dokumenteve për procedurat e konkurimit për tekstet mësimore të përbashkëta për Diasporën, si dhe kriteret e përzgjedhjes së recensuesve të teksteve mësimore të përbashkëta për Diasporën.

Paketa e dokumenteve për procedurat e konkurimit për tekstet mësimore të përbashkëta për Diasporën, përpos standardeve të teksteve mësimore të përbashkëta për Diasporën, të miratuara më parë, përmban dhe procedurën e aplikimit të pjesëmarrësve në konkurim, procedurën e pranimit të teksteve mësimore për konkurim, dokumentacionin ligjor të subjekteve pjesëmarrëse në konkurim, procedurën e vlerësimit të teksteve mësimore nga recensuesit, etj.



"Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"


Shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë tashmë kanë mundësi të aplikojnë për rinovimin e dokumentave të tyre biometrike , si dhe të deklarojnë adresën e tyre të vendbanimit online.

AKD/ Një album fotografik për 85-vjetorin e shkrimtarit Ismail Kadare

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka realizuar një album fotografik në nderim të shkrimtarit të madh të kombit, Ismail Kadare, me rastin e 85 vjetorit të ditëlindjes së tij.

“Kadare dhe Gjirokastra” është një udhëtim nëpërmjet imazheve fotografike në qytetin e lindjes së autorit, në Gjirokastrën e tij të dashur, ku shihet të ecë në rrugicat me kalldrëm, të takojë njerëz që i njeh e jo, të vizitojë vënde që e frymëzuan të krijojë disa nga kryeveprat e tij.


“Realizimi i këtij albumi ishte si një detyrim, që ndjenim se kishim ndaj shkrimtarit të madh shqiptar. Njeriut që bëri Shqipërinë të njohur në mbarë botën, që prej 30 vitesh tsahmë është pjesë e Diasporës, por mbi të gjitha ky është një detyrim që kishim ndaj njeriut që gjuhën letrare kombëtare e ka cilësuar si kryeshenjë e identitetit shqiptar, që e ka mbështetur dhe promovuar identitetin dhe kulturën shqiptare, cka është edhe misioni i Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, tha Drejtoresha e Agjencisë Kombëtare të Diasporës Sonila Hysi.



Vota e Diasporës Shqiptare

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

DITËLINDJA/ Albumi “Kadare dhe Gjirokastra” do të jetë pjesë e Shtëpisë Studio të shkrimtarit



Agjencia Kombëtare e Diasporës, me rastin e 85 vjetorit të shkrimtarit Ismail Kadare, dhuroi për Shtëpinë Studio “Kadare” më Tiranë disa kopje të albumit “Kadare dhe Gjirokastra”, album i realizuar nga Agjencia Kombëtare e Diasporës, në bashkëpunim me artistin Roland Tasho dhe me mbështetjen e Ministrisë të Shtetit për Diasporën.

Virtyti më i rëndësishëm njerëzor është mirënjohja dhe ky album është dhurata e Agjencisë Kombëtare të Diasporës në shenjë mirënjohje ndaj një ambasadori të veçantë të gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare, siç është Kadare.



Është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale e ndryshme në Diasporë rrjetiprofesionisteve.al

PANDEMIA/ “Takimi i mjekësisë në Diasporë” do të mbahet më 24 shkurt

Më 24 shkurt 2021 do të organizohet takimi i dytë i mjekëve shqiptarë në Diasporë.

Ky takim mbahet me iniciativë të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, me mbështetjen e Ministrisë të Shtetit për Diasporën dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në fokus të këtij takimi do të jetë pandemia e COVID-19, kontributi i mjekëve shqiptar jashtë vendit dhe angazhimi i tyre në ndihmë të kolegëve në Shqipëri.

Takimi i dedikohet profesionistëve në fushën e mjekësisë, përfshirë mjekë shqiptarë me veprimtari profesionale në Diasporë dhe mjekë nga Diaspora që janë rikthyer në vendin e origjinës.



Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

BOTIMET E QSPA/ Kolana enciklopedike, veprat e gjashtë autorëve të mirënjohur arbëresh



Këshilli Koordinues i Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA), diskutoi mbi përcaktimin e strategjisë dhe titujve konkretë të botimeve të këtij viti, si dhe planifikimi i kolanës së botimeve në vitet e ardhshme nga ana e QSPA-së.

Tre ishin pikat kryesore të propozuara nga kryetarja e Këshillit Koordinues të QSPA, prof.Merita Bruci: Së pari, listën e veprave që do të botohen këtë vit, ku u vendos botimi i veprave të gjashtë autorëve të mirënjohur arbëreshë, të tillë si: Engjell Mashi, Dhimitër Kamarda, Mikele Marchianó, Zef Skirò (Junior), Francesk Santoriti dhe Maksimilian Lambercit; Së dyti, u miratua në parim kriteri kronologjik si kriteri bazë i përzgjedhjes së veprave kryesore sipas viteve, të cilat do të bëhen pjesë e kolanës enciklopedike që do të botojë QSPA në pesë vitet e ardhshme; Së treti, u vendos që për përgatitjen e kësaj kolane të ngrihet një redaksi e posaçme, me praninë e përfaqësuesve nga tre institucionet kryesore që do të bashkërendojnë punën: QSPA, Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe Akademia e Studimeve Albanologjike (ASA).



Digjitalizimi i Veprave Shqiptare

Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen adld.al

GREQI/ “Lidhja e Mësuesve Shqiptarë” takime online për mësimdhënien në Diasporë



“Lidhja e Mësuesve Shqiptarë” në Greqi gjatë fundjavës realizoi një takim virtual me Drejtoreshën e Qendrës së Botimeve për Diasporën, znj.Mimoza Hysa, në kuadër të përmirësimit të procesit mësimor në Diasporë.

Gjatë takimit të mësuesve në Diasporë me Drejtoreshën e QBD-së u diskutua gjendja aktuale e kurseve të mësimi plotësues të gjuhës shqipe, nevojat dhe problematikat që ka nxjerrë mësimi online. Gjithashtu të dy palët kanë shkëmbyer përvoja mes tyre.

Gjithashtu, LMSHG-ja ishte e pranishme në konferencën e dytë virtuale me temë “Platforma të mësimdhënies online për mësuesit shqiptarë në Diasporë”, organizuar me znj. Drita Gjongecaj, drejtuese e organizatës “Albanian American Dual Language and Culture” në Nju-Jork të SHBA-së.

Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store: [këtu](#) Play store: [këtu](#)